



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 10

Tiranë – E mërkurë, 14 janar 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 6, datë 8.1.2026	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 851
Dekret i Presidentit nr. 9, datë 8.1.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 851
Dekret i Presidentit nr. 10, datë 8.1.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 851
Dekret i Presidentit nr. 11, datë 8.1.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 851
Dekret i Presidentit nr. 12, datë 8.1.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 852
Dekret i Presidentit nr. 13, datë 8.1.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 852
Dekret i Presidentit nr. 14, datë 8.1.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 852
Dekret i Presidentit nr. 15, datë 8.1.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 853
Udhëzim i ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit nr. 4, datë 30.12.2025	Për rregullat e hollësishme mbi lejen për hulumtime arkeologjike..... 853
Udhëzim i ministrit të Punëve të Brendshme nr. 8, datë 7.1.2026	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e ministrit të Brendshëm nr. 93, datë 27.5.2024, “Për përcaktimin e procedurës dhe të dokumentacionit që paraqitet për aplikimin dhe pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë biometrike të zakonshme”, të ndryshuar..... 855

Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe i ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit nr. 27, datë 30.12.2025	Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale, 2026.....	855
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nr. 1, datë 6.1.2026	Për zbatimin e masave të shëndetit publik ndaj kërcënimeve serioze shëndetësore në nivel kufitar.....	859
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 11, datë 7.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	864
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 12, datë 7.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Francës.....	865
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 13, datë 7.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Bullgarisë.....	866
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 14, datë 7.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë...	867
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 15, datë 7.1.2026	Për shfuqizimin e urdhrit nr. 1259, datë 26.11.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Mbretërisë së Bashkuar”.....	868
Urdhër i përbashkët i ministrit të Arsimit dhe i ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit nr. 602, datë 17.12.2025	Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren për zhvillimin e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë.....	869
Vendim i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 381, datë 23.12.2025	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 380, datë 30.11.2023, “Për miratimin e rregullores ‘Për vlerësimin etik dhe profesional të drejtuesve të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm’”, të Këshillit	870

**DEKRET****Nr. 6, datë 8.1.2026****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

I lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:

1. Jorida Agim Ganaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 9, datë 8.1.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:

1. Vlora Ismen Ademaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 10, datë 8.1.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:

1. Arnisa Vangjel Koçollari

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 11, datë 8.1.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,



DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Dorina Petrit Shehi
2. Rabije Luan Zejneli

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 12, datë 8.1.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Erris Muhamet Nushi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 13, datë 8.1.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Sinan Teki Prushi
2. Veton Xhelal Kurhasani

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 14, datë 8.1.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Gjovalin Prengë Lleshi



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 15, datë 8.1.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetas:

1. Tushe Ahmet Grau

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

UDHËZIM
Nr. 4, datë 30.12.2025

**PËR RREGULLAT E HOLLËSISHME
MBI LEJEN PËR HULUMTIME
ARKEOLOGJIKE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të shkronjës “rr”, të nenit 140 dhe të nenit 268, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10027, datë 11.12.2008, “Për aderimin e Republikës së

Shqipërisë në konventën për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nënujore, Paris 2001”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 220, datë 7.4.2021, “Për përcaktimin e procedurave për hulumtimet arkeologjike, të kushteve të posaçme të lëshimit të lejes, dokumenteve shoqëruese, si dhe procedurave për shqyrtimin ose anulimin e lejes për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike”

UDHËZOJ:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky udhëzim ka për objekt përcaktimin e rregullave të hollësishme për mënyrën e zbatimit të lejes për hulumtime arkeologjike, në përputhje me parashikimet e VKM-së nr. 220, datë 7.4.2021, “Për përcaktimin e procedurave për hulumtimet arkeologjike, të kushteve të posaçme të lëshimit të lejes, dokumenteve shoqëruese, si dhe procedurave për shqyrtimin ose anulimin e lejes për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike” (këtej e më poshtë VKM-ja 220/2021)

2. Ky udhëzim zbatohet nga institucionet e specializuara që kryejnë veprimtari të hulumtimit arkeologjik, si dhe subjektet e licencuara që kryejnë hulumtime arkeologjike, sipërfaqësore, nëntokësore dhe nënujore në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore

KREU II
**ZBATIMI I LEJES PËR HULUMTIME
ARKEOLOGJIKE**

1. Hulumtimet arkeologjike kryhen vetëm mbi bazën e lejes së miratuar nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM), sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr. 27/2018, i ndryshuar dhe VKM-në nr. 220/2021.

2. Institucioni i specializuar që kryen veprimtari të hulumtimit arkeologjik ose subjekti i licencuar në fushën e arkeologjisë, i pajisur me leje nga KKTKM-ja për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike mban përgjegjësi të plotë për zbatimin e kushteve të përcaktuara në leje dhe në projektin e miratuar.

3. Çdo leje lidhet me një drejtues projekti, i cili mban përgjegjësi individuale për korrektësinë metodologjike, raportimin dhe ruajtjen e të dhënave.



4. Leja nuk mund të delegohen në institucione apo subjekte të tjera.

KREU III DETYRIMET E SUBJEKTTË GJATË ZBATIMIT TË HULUMTIMIT ARKEOLOGJIK

1. Institucioni i specializuar që kryen veprimtari të hulumtimit arkeologjik ose subjekti i licencuar në fushën e arkeologjisë, i pajisur me leje për hulumtime arkeologjike, është i detyruar:

a) të njoftojë institucionin përgjegjës për fillimin dhe përfundimin e hulumtimit;

b) të zhvillojë hulumtimin arkeologjik brenda kufijve dhe koordinatave të përcaktuara në lejen përkatëse, të miratuar nga KKTKM-ja;

c) të zbatojë projektin e miratuar dhe standardet profesionale të hulumtimit arkeologjik;

d) të njoftojë institucionet përgjegjëse për trashëgiminë kulturore në çdo rast ku vlerësohet dhe gjykohet e nevojshme për ndryshime në projektin e miratuar;

e) të garantojë mbrojtjen, ruajtjen dhe integritetin e gjetjeve dhe/apo vlerave të trashëgimisë kulturore të zbuluara gjatë hulumtimit;

f) të sigurojë kushte ruajtjeje ndaj ndikimit të kushteve atmosferike, si dhe siguri fizike;

g) të bashkëpunojë gjatë mbikëqyrjes nga institucionet përgjegjëse të specializuara;

h) të kryejë dhe të përpilojë dokumentacionin teknik, në përputhje me kriteret e përcaktuara në “Rregulloren e kriterëve të ushtrimit të profesionit të arkeologut” miratuar me vendimin nr. 2, datë 30.1.2009, të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë;

i) në rastin e hulumtimeve arkeologjike të nënujit, përveç sa më sipër, zbatohen edhe rregullat në lidhje me aktivitetet drejtuar ndaj trashëgimisë kulturore nënujore, sipas aneksit të ligjit nr. 10027, datë 11.12.2008, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nënujore, Paris 2001”.

1. Hulumtimet arkeologjike i nënshtrohen mbikëqyrjes dhe kontrollit nga institucionet përgjegjëse, në përputhje me VKM-në nr. 220/2021.

2. Autoritetet përgjegjëse kanë të drejtë inspektimi pa njoftim paraprak.

3. Përfshirja e studentëve të sistemit universitar realizohet nëpërmjet marrëveshjeve përkatëse me

institucionet e arsimit të lartë, institucionet e specializuara dhe subjektet e licencuara, sipas legjislacionit sektorial në fuqi.

KREU IV RAPORTIMI

1. Pas përfundimit të hulumtimit, institucioni i specializuar që kryen veprimtari të hulumtimit arkeologjik ose subjekti i licencuar në fushën e arkeologjisë, i pajisur me leje për hulumtime arkeologjike, paraqet raportin përfundimtar pranë institucionit përgjegjës, sipas afateve dhe kërkesave të përcaktuara në VKM-në nr. 220/2021.

2. Raporti përfundimtar përbën kusht për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit apo subjektit dhe për shqyrtimin e kërkesave të ardhshme për leje.

3. Informacioni/të dhënat si rezultat i hulumtimeve arkeologjike (foto, skica, koordinata, raporte) ruhen dhe depozitohen në format digjital, pranë arkivit teknik të IKTK-së, si dhe pranë institucioneve të specializuara të trashëgimisë kulturore.

4. Pas konfirmimit nga institucionet përgjegjëse të specializuara, informacioni/të dhënat e rezultateve të hulumtimeve arkeologjike (foto, skica, koordinata, raporte), ngarkohen në platformën WebGIS Arkeologjia të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK).

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, institucionet e specializuara që kryejnë veprimtari të hulumtimit arkeologjik dhe subjektet e licencuara në fushën e arkeologjisë, të pajisura me leje për hulumtime arkeologjike dhe hulumtime arkeologjike nënujore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS
DHE SPORTIT
Blendi Gonxhja

**UDHËZIM****Nr. 8, datë 7.1.2026****PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN E MINISTRIT TË
BRENDSHËM NR. 93, DATË 27.5.2024,
“PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS
DHE TË DOKUMENTACIONIT QË
PARAQITET PËR APLIKIMIN DHE
PAJISJEN E SHTETASVE SHQIPTARË
ME PASAPORTË BIOMETRIKE TË
ZAKONSHME”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 6 dhe të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 8668, datë 23.10.2000, “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin e ministrit të Brendshëm nr. 93, datë 27.5.2024, “Për përcaktimin e procedurës dhe të dokumentacionit që paraqitet për aplikimin dhe pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë biometrike të zakonshme”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

1. Në nenin 5, pika 4, pas togfjalëshit “...me procedurë të përsheptuar,” shtohet togfjalëshi “...dhe me procedurë normale.”.

Neni 2

1. Në nenin 14, bëhen këto ndryshime:

a) Pas pikës 1, shtohet pika 1/1, me përmbajtjen si vijon:

“Në zyrat e misionit diplomatik ose postit konsullor, asgjësimi i bandës MRZ dhe i dokumenteve shoqëruese të aplikimit kryhet nga vetë përfaqësia, në përputhje me nenin 13 të këtij udhëzimi.”;

b) Në pikën 2, fjalja e parë, riformulohet dhe ndryshon me këtë përmbajtje:

“Pasaportat biometrike të prodhuara, që gjenden në Zyrat e Shpërndarjes pranë drejtorive vendore të Policisë së Shtetit dhe/ose pranë zyrave të misionëve diplomatike ose posteve

konsullore, ruhen të paktën për një periudhë 12-mujore, por jo më vonë se muaji dhjetor i vitit pasardhës, referuar vitit të prodhimit të pasaportës.”.

Neni 3**Dispozita përfundimtare**

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet shoqëria “IdentiTek” sh.a., Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME
Albana Koçi

UDHËZIM**Nr. 27, datë 30.12.2025****PËR ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN
E PROVIMEVE TË MATURËS
SHTETËRORE DHE TË MATURËS
SHTETËRORE PROFESIONALE, 2026**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 26 dhe 51, të ligjit nr. 69, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 7, e nenit 8, të ligjit nr. 15/2017, datë 16.2.2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

UDHËZOJMË:**I. Matura Shtetërore**

1. Lëndët e provimeve të Maturës Shtetërore 2026, për arsimin e mesëm të lartë janë:

a) Provime të detyruara:

i. Gjuhë e huaj;

ii. Gjuhë shqipe dhe letërsi;

iii. Matematikë;

b) Një provim me zgjedhje.

2. Provime të detyruara:

a) Provimet e detyruara të mbështeten vetëm në kurrikulën bërthamë. Programet orientuese të provimeve të detyruara (Gjuhë shqipe dhe letërsi, Matematikë, Gjuhë e huaj) për të gjithë



maturantët/kandidatët janë në përshtatje me programet ekzistuese të arsimit të mesëm të lartë;

b) Testi i gjuhës së huaj (D3) hartohet në përputhje me gjuhën e cila në planin mësimor të arsimit të mesëm të lartë trajtohet si gjuhë e huaj e parë. Testi i provimit të jetë në nivelin gjuhësor që përcaktohet në kurrikul në përfundim të arsimit të mesëm të lartë;

c) Lista e gjuhëve të huaja, që jepen si provim i detyruar (D3) është: anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht dhe spanjisht. Gjuha e huaj si provim i detyruar përzgjidhet gjatë plotësimit të formularit A1/A1Z.

3. Provimi me zgjedhje:

a) Lista e lëndëve të provimit me zgjedhje është, si më poshtë:

- i. Kimi;
- ii. Fizikë;
- iii. Biologji;
- iv. Histori;
- v. Gjeografi;
- vi. Qytetari dhe Psikologji;
- vii. Filozofi dhe Sociologji;
- viii. Ekonomi;
- ix. Histori Arti;
- x. Histori Muzike;
- xi. Histori Baleti;

b) Programet orientuese të lëndëve me zgjedhje, janë të njëjta për të gjithë maturantët/kandidatët që plotësojnë formularin A1/A1Z;

c) Programi orientues i lëndëve me zgjedhje përmban programin e lëndës bërthamë dhe atë me zgjedhje;

d) Maturanti/kandidati zgjedh një lëndë nga lista e lëndëve me zgjedhje, pavarësisht nëse i ka zhvilluar ose jo, apo i janë ofruar ose jo ato nga shkolla në programin mësimor.

4. Kandidatit, që ka dhënë dy ose më shumë provime me zgjedhje dhe është vlerësuar me notë të përshkallëzuar jo më të vogël se 4.50 (nota 5), i njihen ato provime dhe nuk mund t'i japë më.

5. Kandidatët, të cilët rezultojnë mbetës në të paktën njërin prej provimeve të Maturës Shtetërore, duhet ta rijapin atë, që të pajisen me diplomë.

6. Kandidatët, që në Maturat Shtetërore 2012–2025 nuk kanë rezultuar kalues në asnjë prej provimeve që kanë zgjedhur për të dhënë, japin vetëm një lëndë nga lista e lëndëve të provimit me zgjedhje, të përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 3 të këtij udhëzimi.

7. Gjuha e huaj, si provim i detyruar, përzgjidhet gjatë plotësimit të formularit A1/A1Z. Kandidatët e viteve të kaluara (të maturave shtetërore 2014–2025) që kanë rezultuar jokalues në provimin D3, duhet ta rijapin këtë provim. Kandidatët e tjerë, (të maturave shtetërore para vitit 2014) që aplikojnë me A1Z, nuk e rijapin provimin e detyruar D3.

8. Datat për provimet e Maturës Shtetërore 2026 janë:

- | | |
|-----------------------------|------------------|
| a) Gjuhë e huaj | 2 qershor 2026; |
| b) Gjuhë shqipe dhe letërsi | 9 qershor 2026; |
| c) Matematikë | 16 qershor 2026; |
| d) Provimi me zgjedhje | 23 qershor 2026. |

9. Provimet e Maturës Shtetërore 2026 fillojnë në orën 10:00 dhe zgjasin 2 orë e 30 minuta.

10. Testet e provimeve të Maturës Shtetërore 2026 hartohen, administrohen dhe vlerësohen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA).

11. Testi për secilin nga provimet e Maturës Shtetërore 2026 përmban pyetje të 3 niveleve të arritjes dhe vlerësohet me 60 pikë maksimale.

12. Testi i veçantë i hartuar për nxënësit me aftësi të kufizuara, për secilin nga provimet e Maturës Shtetërore 2026, përmban vetëm pyetje të nivelit të parë dhe të dytë të arritjes, dhe vlerësohet me pikët maksimale që i korrespondojnë nivelit të dytë.

13. Testi i veçantë për nxënësit me aftësi të kufizuara përzgjidhet sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren për zhvillimin e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë.

14. Testi i provimeve për maturantët e Qendrës Burimore për Nxënësit që Nuk Dëgjojnë, hartohet sipas kritereve të përcaktuara në rregulloren për zhvillimin e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë.

15. Maturantët/kandidatët që rezultojnë mbetës në provimet e Maturës Shtetërore 2026, i rijapin provimet në sesionin e dytë.

16. Zyrtat vendore arsimore parauniversitare (ZVAP) pasi marrin nga institucionet e arsimit të mesëm të lartë listat e maturantëve mbetës të vitit shkollor 2025–2026, i pasqyrojnë ato në portalin *e-Matura*, sipas urdhrit dhe kalendarit të përcaktuar nga QSHA-ja. Këto lista dërgohen në QSHA, në format të printuar dhe elektronik.

17. Institucionet e arsimit të mesëm të lartë të organizojnë konsultimet në ndihmë të nxënësve maturantë për provimet e Maturës Shtetërore sipas një kalendarit të miratuar nga ZVAP-ja. Këto



konsultime do të jenë objekt monitorimi nga Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar.

18. Testi i provimit “Gjuhë dhe letërsi italiane” (*Lingua e literatura italiana*) për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-italiane përgatitet nga ministria përgjegjëse për arsimin në Republikën e Italisë dhe dorëzohet në QSHA në afatin kohor të përcaktuar për këtë provim. Ky provim zhvillohet në datën 2 qershor 2026 dhe zëvendëson provimin e gjuhës së huaj (D3) për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-italiane. Në notën e provimit përfshihet, siç është parashikuar në marrëveshje ndërmjet palëve, edhe vlerësimi i zhvilluar në shkollë në datën 28 maj 2026, para një komisioni të ngritur nga palët.

19. Testi i provimit “Gjuhë frënge” (DELF B2 scolaire) për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-franceze përgatitet nga Ambasada Franceze në Tiranë dhe provimi zhvillohet në datën 28 maj 2026, në shkollat përkatëse.

20. Tërheqja e testeve të provimeve të Maturës Shtetërore 2026 bëhet sipas grafikut të hartuar nga QSHA-ja dhe të miratuar nga Komiteti i Maturës Shtetërore 2026.

21. Provimet Kombëtare të Maturës Shtetërore 2026 zhvillohen në qendrat e provimeve të përcaktuara nga Komisioni i Maturës Shtetërore në ZVAP, mbështetur në Rregulloren e Maturës Shtetërore.

II. Matura Shtetërore Profesionale

1. Provimet e Maturës Shtetërore Profesionale 2026 për shkollat e mesme profesionale, janë:

a) Provime të detyruara:

i. Gjuhë e huaj;

ii. Gjuhë shqipe dhe letërsi;

iii. Matematikë;

iv. Teori profesionale e integruar (sipas kualifikimit profesional që maturanti/kandidati ka ndjekur në shkollë).

2. Datat për provimet e Maturës Shtetërore Profesionale 2026, janë:

a) Gjuhë e huaj	2 qershor 2026;
b) Gjuhë shqipe dhe letërsi	9 qershor 2026;
c) Matematikë	16 qershor 2026;
d) Teori profesionale e integruar	23 qershor 2026.

3. Testi i gjuhës së huaj (D3) hartohet në përputhje me gjuhën e cila në planin mësimor të arsimit të mesëm profesional trajtohet si gjuhë e huaj e parë. Testi i provimit të jetë në nivelin gjuhësor që përcaktohet në kurrikul në përfundim të arsimit të mesëm profesional.

4. Gjuha e huaj, si provim i detyruar, përzgjidhet gjatë plotësimit të formularit A1/A1Z. Kandidatët e viteve të kaluara (të maturave shtetërore 2014–2025), që kanë rezultuar jokalue në provimin D3, duhet ta rijapin këtë provim. Kandidatët e tjerë (të maturave shtetërore para vitit 2014), që aplikojnë me A1Z, nuk e rijapin provimin e detyruar D3.

5. Lista e provimeve të detyruara të Teorisë profesionale të integruar, sipas kualifikimit profesional që maturantët/kandidatët kanë ndjekur në shkollat profesionale, është:

Nr.	Lista e Kualifikimeve profesionale
1	Hoteleri-turizëm
2	Shërbime mjetesht transporti
3	Mekanikë
4	Elektroteknikë
5	Elektronikë
6	Përpunim druri
7	Ndërtim
8	Tekstil-konfeksione
9	Tekstil-konfeksione (NABER ADA)
10	Teknologji ushqimore
11	Bujqësi
12	Shërbime sociale dhe shëndetësore
13	Instalues i sistemeve termohidraulike
14	Teknologji kimike
15	Peshkim



16	Detari
17	Gjeologji-miniera
18	Llogari
19	Shërbime bankare
20	Sipërmarrje e agjencisë turistike
21	Sigurime
22	Tregti
23	Administrim biznesi
24	Rrjete të dhënash
25	Mbështetje e përdoruesve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit
26	Zhvillim Website
27	Rrjete të dhënash (pilot-GIZ)
28	Inxhinieri informatike softwaresh (<i>Hermann Gmeiner</i>)
29	Silvikulturë
30	Agrobiznes
31	Veterinari
32	Gjeodezi
33	Biznes (Harry Fultz)
34	Elektronikë (Harry Fultz)
35	Automekanik (Harry Fultz)
36	Kërkim, shpim dhe shfrytëzim për naftë, gaz dhe ujë
37	Shërbime, kujdesi për të moshuar (pilot GIZ)
38	Shërbime udhëtimi dhe turizmi
39	Riparime të pajisjeve elektronike
40	Telekomunikacion
41	Teknologji Bujqësore
42	Programim
43	Multimedia
44	Administrim zyre
45	Shërbime mekatronike në automjete
46	Termohidraulikë
47	Guidë turistike

6. Provimet e detyruara “Gjuhë shqipe dhe letërsi”, “Matematikë”, “Gjuhë e huaj e parë”, dhe programet orientuese të tyre, mbështeten në programet ekzistuese të kulturës së përgjithshme të arsimit profesional.

7. Provimet e detyruara të Teorisë profesionale të integruar, sipas tabelës në pikën 5, mbështeten në programet orientuese të Maturës Shtetërore Profesionale, të publikuara në faqet e Agjencisë Kombëtare të Arsimit Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe të Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

8. Kandidati i cili rezulton mbetës në të paktën njërin prej provimeve të detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale, rijep atë që të pajiset me diplomë.

Faqe | 858

9. Kandidati që në Maturën Shtetërore të viteve 2012–2019:

a) ka zgjedhur Teorinë profesionale të integruar dhe është kalues, të pajiset me diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale, pavarësisht se mund të rezultojë jo kalues në një apo dy provimet e tjera me zgjedhje;

b) ka zgjedhur Teorinë profesionale të integruar dhe rezulton mbetës, duhet të rijapë provimin e detyruar të Teorisë profesionale të integruar, pavarësisht rezultateve të provimeve të tjera me zgjedhje;

c) ka zgjedhur dy apo tri lëndë me zgjedhje, tek të cilat nuk përfshihet Teoria profesionale e integruar, duhet të japë provimin e detyruar të



Teorisë profesionale të integruar, pavarësisht rezultateve të provimeve të tjera me zgjedhje.

10. Kandidatët që kanë marrë dëftesë pjekurie para vitit 2011 dhe dëshirojnë të aplikojnë për studime në institucionet e arsimit të lartë, ju njihen provimet e detyruara ose provimet e njëvleftshme me to, të njësuara nga njësitë arsimore vendore. Këta kandidatë, në rastet kur nuk kanë dhënë provimin e Teorisë profesionale të integruar ose e kanë dhënë dhe nuk kanë rezultuar kalues, kanë të drejtë të japin këtë provim, kur e kanë të nevojshme për plotësimin e kriterëve të pranimit të përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë.

III. Dispozitat e fundit

1. Administrimi i provimeve të Maturës Shtetërore dhe Maturës Shtetërore Profesionale 2026 bazohet në Rregulloren e Maturës Shtetërore.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar, Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT
Mirela Kumbaro Furxhi

MINISTËR I EKONOMISË DHE
INOVACIONIT
Delina Ibrahimaj

URDHËR

Nr. 1, datë 6.1.2026

PËR ZBATIMIN E MASAVE TË SHËNDETIT PUBLIK NDAJ KËRCËNIMEVE SERIOZE SHËNDETËSORE NË NIVEL KUFITAR¹

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 10 138, datë 11.5.2009, “Për shëndetin publik”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10 107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Zbatimin e masave të shëndetit publik, që lidhen me kategoritë e mëposhtme të kërcënimeve serioze shëndetësore në nivel kufitar:

a) kërcënimet me origjinë biologjike, ku bëjnë pjesë:

i. sëmundjet ngjitëse, përfshirë ato me origjinë zoonotike;

ii. rezistenca ndaj antimikrobikëve dhe infeksionet e lidhura me kujdesin shëndetësor, që bëjnë pjesë të sëmundjet ngjitëse, si: “çështje të veçanta të lidhura me shëndetin”;

iii. biotoksina ose agjentë të tjerë të dëmshëm biologjikë, që nuk lidhen me sëmundjet ngjitëse;

b) kërcënimet me origjinë kimike;

c) kërcënimet me origjinë mjedisore, përfshi ato që burojnë nga ndryshimet klimatike;

d) kërcënimet me origjinë të panjohur; dhe

e) ngjarjet, që mund të përbëjnë emergjencë të shëndetit publik me rëndësi kombëtare sipas Rregullores Ndërkombëtare të Shëndetit, (IHR), me kusht që ato të përfshihen në njërin nga kategoritë e kërcënimeve të përcaktuara në gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”, të pikës 2, të këtij urdhri.

2. Të zbatohet survejanca epidemiologjike e sëmundjeve infektive dhe të çështjeve të veçanta të lidhura me to, në të gjithë vendin.

3. Në situata të jashtëzakonshme emergjente, vendi të kërkojë ndihmë për koordinimin e reagimit

¹ * Ky urdhër është përafuar me Rregulloren e BE-së 2022/2371, të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, të

datës 22 nëntor 2022 mbi kërcënimet serioze shëndetësore në nivel kufitar.



në Komisionin Evropian përmes Komitetit të Sigurisë Shëndetësore (HSC), për kërcënime serioze në nivel kufitar për shëndetin, të tjera nga ato të përmendura në pikën 2, të këtij urdhri, nëse konsiderohet se masat e mëparshme të shëndetit publik janë të pamjaftueshme, si dhe të kërkojë koordinimin e shkëmbimit të informacionit midis mekanizmave dhe të strukturave, veprimtaritë e të cilave janë të rëndësishme për parandalimin, përgatitjen dhe planifikimin e reagimit, monitorimin, paralajmërimin e hershëm dhe luftimin ndaj kërcënimeve serioze në nivel kufitar për shëndetin.

4. Shqipëria do të ruajë të drejtën të fusë në zbatim marrëveshje, procedura dhe masa shtesë në fushat e përmendura në pikat 2 dhe 3, të këtij urdhri, përfshirë marrëveshjet e parashikuara në traktate ose konventa dypalëshe apo shumëpalëshe, ekzistuese ose të ardhshme, me kusht që këto të mos pengojnë zbatimin e këtij urdhri.

5. Shqipëria njihet rolin e Komitetit të Sigurisë Shëndetësore dhe do të përcaktojë, me propozim të ministrit përgjegjës për shëndetësinë, një përfaqësues të fushës së kërcënimeve serioze në nivel kufitar për shëndetin dhe jo më shumë se dy anëtarë zëvendësues në Komitetin e Sigurisë Shëndetësore me statusin e vëzhguesit apo anëtarit. Ky përfaqësues ka për detyrë të marrë pjesë në takimet e këtij komiteti dhe të informojë menjëherë ministrin përgjegjës për shëndetësinë dhe institucionet përkatëse, në lidhje me diskutimet, masat dhe përfundimet e takimeve apo publikimin e tyre në faqen e internetit të komisionit.

6. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë, në bashkëpunim me institucionet e saj të varësisë, të përgatisë planin kombëtar për parandalimin, përgatitjen dhe përgjigjen mbështetur në udhëzimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe ECDC-së.

7. Planin kombëtar të përfshijë elemente që lidhen me qeverisjen, kapacitetet dhe burimet. Ky plan duhet të rishikohet çdo tre vjet apo sa herë të nevojiten ndryshime sipas gjendjes epidemiologjike. Për të përgatitur këtë plan, ministria përgjegjëse për shëndetësinë të konsultohet edhe me organizatat e pacientëve, organizatat e profesionistëve të kujdesit shëndetësor apo palë të tjera në zinxhirin e furnizimit, si dhe me partnerët socialë kombëtarë.

8. Të përgatitet çdo tre vjet një raport mbi planifikimin dhe zbatimin e parandalimit, përgatitjes dhe përgjigjes në nivel kombëtar dhe/ose në nivele

kufitare ndërrajonale. Ky raport duhet të bazohet në tregues të përbashkët të dakordësuar që kur përgatitet plani dhe të japë një pasqyrë të veprimeve të zbatuara në vend, si më poshtë:

a) të identifikojë dhe të përditësojë statusin e zbatimit të standardeve të kapaciteteve për parandalimin, përgatitjen dhe planifikimin e përgjigjes në nivelin kombëtar dhe kur është e përshtatshme, edhe në nivel kufitar ndërrajonal për sektorin shëndetësor, në përputhje me udhëzimet e OBSH-së, sipas Rregullores Ndërkombëtare të Shëndetit, si dhe të paraqesë marrëveshjet e ndërveprimit midis sektorit shëndetësor dhe sektorëve të tjerë kritikë në situata emergjente;

b) të përditësojë mbi elementet e parandalimit, përgatitjes dhe planifikimit të përgjigjes në situata emergjente, në veçanti për:

i. *qeverisjen*: duke përfshirë politikën dhe legjislacionin kombëtar, që integron veprimet në lidhje me emergjencën dhe përgatitjen; planet për parandalimin, përgatitjen, përgjigjen dhe rikuperimin nga emergjencat; mekanizmat e koordinimit, midis niveleve administrative kombëtare, rajonale ose lokale dhe në kuadër të bashkëpunimit ndërsektorial;

ii. *kapacitetet*: duke përfshirë vlerësimet e rrezikut dhe kapaciteteve, për të përcaktuar prioritetet për përgatitjen ndaj emergjencave; survejancën dhe paralajmërimin e hershëm, menaxhimin e informacionit; masat dhe rregulloret, që synojnë të sigurojnë qasje të vazhdueshme në shërbimet diagnostike, instrumentet dhe produktet mjekësore gjatë emergjencave, nëse ato janë vazhdimisht në dispozicion; shërbimet shëndetësore themelore dhe të sigurta, duke respektuar nevojat dhe barazinë gjinore; pasqyrën e ndikimit të kërcënimeve të rënda në nivel kufitar për shëndetin në ofrimin dhe vazhdimësinë e shërbimeve shëndetësore për sëmundje dhe kushte të tjera gjatë emergjencave të shëndetit publik; komunikimin e rrezikut dhe zhvillimin e kërkimeve e vlerësimeve, për të informuar dhe përshpejtuar përgatitjen për emergjencë;

iii. *burimet*: duke përfshirë këtu burimet financiare për përgatitjen ndaj emergjencave dhe plane të kontigjencës për përgjigjen; medikamentet, pajisjet dhe mjetet e nevojshme thelbësore për shëndetin; mekanizmat e logistikës, përfshirë këtu ato që shërbejnë për ruajtjen e masave mjekësore; burimet



njerëzore të dedikuara, të trajnuara dhe të pajisura për situata të emergjencës;

c) të zbatojë planin kombëtar të parandalimit, përgatitjes dhe reagimit, duke përfshirë, aty ku është e nevojshme, zbatimin në çdo nivel të qeverisjes, përfshirë këtu përgjigjen ndaj epidemive; rezistencën antimikrobike, infeksionet e lidhura me kujdesin shëndetësor dhe kërcënimet e tjera serioze në nivel kufitar për shëndetin, sipas pikës 2 të këtij urdhri;

d) të pasqyrojë konsultimet me partnerët përkatës për vlerësimin e rrezikut dhe planin kombëtar të parandalimit, përgatitjes dhe përgjigjes;

e) veprimet e ndërmarra për të përmirësuar boshllëqet e gjetura në zbatimin e planit kombëtar të parandalimit, përgatitjes dhe përgjigjes. Raporti duhet të përfshijë edhe elementet në nivel kufitar ndërrajonalë dhe ndërsektorialë të parandalimit, përgatitjes dhe përgjigjes, duke përfshirë vendet fqinje dhe mekanizmat e koordinimit për elementet përkatëse të planeve kombëtare të parandalimit, përgatitjes dhe përgjigjes, trajnimin në nivel kufitar, si edhe ndarjen e praktikave më të mira, për stafin e kujdesit shëndetësor dhe stafin e shëndetit.

9. Të paraqitet pranë ECDC-së dhe Komisionit Evropian, brenda nëntë muajve nga kryerja e vlerësimit nga ECDD-ja, një plan veprimi, që adreson rekomandimet e propozuara të vlerësimit. Ky plan veprimi të përfshijë: a) veprime rregullatore; b) iniciativa trajnimi; c) një përmbledhje të praktikave të mira.

10. Të sigurohet pjesëmarrja në trajnimet për elementet përkatëse të planeve kombëtare të parandalimit, përgatitjes dhe përgjigjes, dhe ato të Komisionit Evropian, të organizuara nga ECDC-ja dhe OBSH-ja.

11. Të merren masa për të ndërtuar mekanizma dhe procedura të pjesëmarrjes, të lidhura me prokurimin e përbashkët me Bashkimin Evropian, por edhe vendet fqinje të rajonit, për mjetet, medikamentet, vaksinat dhe pajisjet e nevojshme mjekësore të përgjigjes, duke përcaktuar qartë procedurën, vlerësimin e prokurimit të përbashkët e të tenderimit, si dhe të menaxhimit të kontratës.

12. Prokurimi i përbashkët nuk duhet të prejë tregun e brendshëm dhe nuk duhet të çojë në diskriminim, kufizimin e tregut apo garës, duke vlerësuar përherë impaktin në buxhet.

13. Të merren masa për të qenë pjesë e rrjetit të survejancës epidemiologjike të sëmundjeve infektive të Bashkimit Evropian, si edhe të sigurojë

komunikimin e vazhdueshëm për këto sëmundje me ECDC-në dhe Komisionin, nëpërmjet Institutit të Shëndetit Publik, si autoriteti kombëtar për survejancën epidemiologjike në nivel kombëtar.

14. Nëpërmjet pjesëmarrjes në rrjetin e survejancës epidemiologjike të sëmundjeve infektive të Bashkimit Evropian, të sigurohet:

a) monitorimi i prirjeve të sëmundjeve infektive sipas kohës, duke e krahasuar me vendet e Bashkimit Evropian dhe vendet e rajonit, për të vlerësuar situatën, për t'iu përgjigjur rritjes mbi pragjet e paralajmërimit dhe për të lehtësuar veprimet e bazuara në evidenca;

b) zbulimi dhe monitorimi i çdo shpërthimi në nivel kufitar të sëmundjeve infektive, në lidhje me burimin, kohën, popullsinë dhe vendin;

c) vlerësimi dhe monitorimi i programeve të parandalimit dhe kontrollit të sëmundjeve infektive në mënyrë që të sigurohen evidenca të qarta për rekomandime, për të forcuar dhe përmirësuar këto programe në nivel kombëtar;

d) identifikimi dhe monitorimi i faktorëve të rrezikut për transmetimin e sëmundjeve dhe grupet e popullsisë në rrezik që kanë nevojë për masa të veçanta parandaluese;

e) vlerësimi i barrës së sëmundjeve infektive në popullatë, duke përdorur të dhëna të tilla, si: prevalenca e sëmundjeve, komplikacionet e tyre, shtrimet në spitale dhe vdekshmërinë;

f) vlerësimi i kapacitetit të sistemeve shëndetësore për të diagnostikuar, parandaluar dhe trajtuar sëmundje specifike infektive, me prioritet sigurinë e pacientit në kontekstin e kërcënimeve serioze në nivel kufitar për shëndetin;

g) modelimi dhe zhvillimi i skenarëve të përgjigjes;

h) identifikimi i prioriteteve dhe nevojave të kërkimit, dhe zbatimit të aktiviteteve përkatëse kërkimore që synojnë forcimin e shëndetit publik;

i) mbështetje për masat e lidhura me gjurmimin e kontakteve nga autoritetet kompetente shëndetësore.

15. Instituti i Shëndetit Publik të komunikojë pranë ECDC-së informacionin e mëposhtëm:

a) të dhëna dhe informacione në lidhje me survejancën epidemiologjike të sëmundjeve infektive dhe çështjeve të veçanta shëndetësore të lidhura me to;



b) informacione të përditësuara, në lidhje me ecurinë e situatave epidemike, duke përfshirë modelimin dhe zhvillimin e skenarëve;

c) informacione relevante, në lidhje me ndodhi jo të zakonshme epidemike ose sëmundje të reja ngjitëse me origjinë të panjohur;

d) të dhëna molekulare për patogjene të ndryshme, nëse kërkohen për zbulimin ose hetimin e kërcënimeve serioze në nivel kufitar për shëndetin;

e) të dhëna të sistemeve shëndetësore të nevojshme për menaxhimin e kërcënimeve serioze në nivel kufitar për shëndetin; dhe

f) informacione në lidhje me sistemet e monitorimit të gjurmimit të kontakteve të zhvilluara në nivel kombëtar.

16. Të sigurohet funksionimi i sistemeve të integruara të survejancës dhe të raportohet nëpërmjet Institutit të Shëndetit Publik në sistemet e platformës digjitale të ECDC-së dhe Komisionit Evropian me sisteme digjitale dhe ndërvepruese.

17. Laboratorët kombëtarë të referencës të jenë pjesë e rrjetit të laboratorëve evropianë të referencës apo vendeve të tjera të zhvilluara, si: Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kanadaja, Australia, Zvicra, etj. për:

a) referencat diagnostike, duke përfshirë protokollat e testimit;

b) burimet e materialeve për laboratorët e referencës;

c) vlerësimet e jashtme të cilësisë;

d) sigurimin e këshillave shkencorë dhe asistencës teknike;

e) bashkëpunimin dhe kërkimin;

f) monitorimin, njoftimet dhe mbështetjen në përgjigjen ndaj shpërthimeve, duke përfshirë sëmundjet infektive emergjente nga bakteret dhe viruset patogjene;

g) trajnimin.

18. Instituti i Shëndetit Publik të njoftojë alarmet shëndetësore të vlerësuara më parë prej tij, pranë platformave të Bashkimit Evropian dhe ECDC-së, nëse ky alarm:

a) është i pazakontë ose i papritur për vendin dhe kohën e dhënë, dhe shkakton ose mund të shkaktojë sëmundshmëri ose vdekshmëri të konsiderueshme tek njerëzit, rritet me shpejtësi, ose mund të rritet me shpejtësi sipas shkallëve, është duke tejkaluar ose mund të tejkalojë kapacitetin kombëtar të përgjigjes;

b) prek ose mund të prekë më shumë se një shtet apo vend kufitar;

c) kërkon ose mund të kërkojë një përgjigje të koordinuar në nivel të Bashkimit Evropian apo Ndërkombëtar;

d) mund të përbëjë emergjencë të shëndetit publik me shqetësim ndërkombëtar sipas Rregullores Ndërkombëtare të Shëndetit.

19. Informacioni i nevojshëm për koordinimin e përgjigjes, të përfshijë:

i. llojin dhe origjinën e agentit;

ii. datën dhe vendin e incidentit ose shpërthimit;

iii. mjetet dhe mënyrën e transmetimit ose përhapjes;

iv. të dhënat toksikologjike;

v. metodat e zbulimit dhe konfirmimit;

vi. rreziqet e shëndetit publik;

vii. masat e shëndetit publik të zbatuara ose që synohet të merren në nivel kombëtar;

viii. masa të tjera përveç masave të shëndetit publik, duke përfshirë masat ndersektorale;

ix. nëse ka nevojë urgjente për mjete, medikamente, vaksina, teste etj.;

x. kërkesat dhe ofertat për ndihmë emergjente në nivel kufitar, siç është transferimi mjekësor i pacientëve ose sigurimi i stafit të kujdesit shëndetësor, veçanërisht në zonat në nivel kufitar në rajonet fqinje;

xi. të dhënat personale të nevojshme për qëllimin e gjurmimit të kontakteve, në përputhje me ligjet kombëtare dhe ato të Bashkimit Evropian;

xii. çdo informacion tjetër të rëndësishëm për kërcënimin aktual serioz në nivel kufitar ndaj shëndetit.

20. Instituti i Shëndetit Publik të krijojë kapacitetet, të përgatisë raporte në lidhje me vlerësimin e riskut për shëndetin publik dhe të koordinojë veprimet e tij me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë.

21. Koordinimi me ECDC-në, OBSH-në, vendet anëtare, si dhe vende të tjera partnere të bëhet, në lidhje me:

a) përgjigjen kombëtare, duke përfshirë nevojat e kërkimit ndaj kërcënimit serioz në nivel kufitar për shëndetin, si edhe rastet kur një emergjencë shëndetësore e shëndetit publik me rëndësi ndërkombëtare shpallet në përputhje me Rregulloren Ndërkombëtare të Shëndetit;

b) komunikimin e rrezikut dhe krizës, që duhet të përshtatet me nevojat dhe rrethanat e vendit, me qëllim ofrimin e informacionit të qëndrueshëm dhe të koordinuar pranë Bashkimit Evropian dhe



OBSH-së për publikun, profesionistët e kujdesit shëndetësor dhe profesionistët e shëndetit publik;

c) miratimin e opinioneve dhe udhëzimeve, duke përfshirë masat specifike të përgjigjes për parandalimin dhe kontrollin e një kërcënimi serioz në nivel kufitar për shëndetin, bazuar në opinionin e ekspertëve ose organeve teknike përkatëse të vendit.

22. Në rastin kur synohet miratimi ose ndërprerja e masave të shëndetit publik për të luftuar një kërcënim serioz në nivel kufitar për shëndetin, përpara miratimit ose ndërprerjes, duhen informuar, konsultuar dhe koordinuar me shtetet e tjera anëtare, në veçanti me shtetet anëtare fqinje, si dhe Komisionin, mbi natyrën, qëllimin dhe fushëveprimin e këtyre masave, përveç nëse nevoja për të mbrojtur shëndetin publik është aq urgjente saqë miratimi i menjëhershëm i këtyre masave është i nevojshëm.

23. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë, në rastin kur i duhet të miratojë si çështje urgjente masa të shëndetit publik në përgjigje të shfaqjes ose rishfaqjes së një kërcënimi serioz në nivel kufitar për shëndetin, duhet të informojë menjëherë OBSH-në, ECDC-në dhe Komisionin Evropian për natyrën, qëllimin dhe fushëveprimin e këtyre masave, veçanërisht në rajonet në nivel kufitar.

Nëse është e nevojshme, në rast të një kërcënimi serioz në nivel kufitar për shëndetin, mund të kërkojë ndihmë nga Komisioni Evropian, OBSH-ja dhe vende të tjera partnere.

24. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë rekomandon masa të përkohshme të shëndetit publik, të cilat duhet:

a) të bazohen në rekomandimet e ECDC-së dhe OBSH-së, agjencive ose organeve të tjera përkatëse të Bashkimit Evropian;

b) të respektojnë përgjegjësitë e shteteve të tjera fqinje dhe sidomos ato të BE-së, dhe vendeve të tjera partnere, për përcaktimin e politikave të tyre shëndetësore, si dhe për organizimin e ofrimit të shërbimeve shëndetësore dhe kujdesit mjekësor;

c) të jenë të nevojshme, të përshtatshme dhe proporcionale me rreziqet e shëndetit publik, që lidhen me kërcënimin përkatës serioz në nivel kufitar për shëndetin, duke shmangur, në veçanti, çdo kufizim të panevojshëm të lëvizjes së lirë të personave, të mallrave dhe të shërbimeve, si edhe të nxisin koordinimin e masave me ECDC-në, Bashkimin Evropian dhe vendet e tjera partnere;

d) t'u vihen në dispozicion të gjitha autoriteteve kompetente kombëtare, OBSH-së, ECDC-së dhe vendeve të Bashkimit Evropian, qoftë dhe përmes sistemeve të lidhura të alarmit; në rastet kur rekomandimi do të bëhet publik, ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe Instituti i Shëndetit Publik duhet ta transmetojnë atë 24 orë para publikimit, përveç rasteve kur nevoja është aq urgjente sa publikimi i menjëhershëm i rekomandimit është i nevojshëm.

25. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë ndjek udhëzimet e ECDC-së, OBSH-së dhe të ekspertëve kombëtarë për të konsideruar kërcënimin përkatës serioz në nivel kufitar për shëndetin, përfshirë këtu edhe pandeminë.

26. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë përcakton edhe përfundimin e kërcënimit pas përfundimit të arsyeve të shpalljes së tij, sipas përcaktimeve të mësipërme, duke njoftuar OBSH-në dhe ECDC-në.

27. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë merr masa për kryerjen e vlerësimeve përkatëse të përgjigjes, menjëherë pas datës së përfundimit të kërcënimit përkatës serioz në nivel kufitar për shëndetin.

28. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe Instituti i Shëndetit Publik.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MIRËQENIES SOCIALE
Evis Sala



**URDHËR PËR ZBATIMIN E MASAVE TË SHËNDETIT PUBLIK NDAJ KËRCËNIMEVE
SERIOZE SHËNDETËSORE NË NIVEL KUFTAR**

Tabela e përputhshmërisë

Nene	Paraqitja në urdhër – pika	Shkalla e përputhshmërisë	Shënime
1	NA	NA	Ky nen përshkruan rregulloren prandaj nuk është i aplikueshëm.
2	2, 3, 4, 5	E plotë	
3	NA	NA	Ky nen është fjalor i përkufizimeve dhe nuk ka nevojë pasi ato janë të përshkruara dhe sqaruara në ligjin nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, apo dokumente të tjera.
4	6	E pjesshme	Kjo pasi bazohet në detyrat e Komitetit të Sigurisë Shëndetësore dhe Shqipëria nuk është akoma vend anëtar i BE-së.
Kap. 2–5, 6, 7, 8, 9, 10, 11	7, 8, 9, 10, 11	E pjesshme (thuhet e plotë)	Kjo pasi bazohet në detyrat e Komisionit dhe, po ashtu, Shqipëria nuk është akoma vend anëtar i BE-së.
Kap 2–12	12, 13, 14	E pjesshme	Shqipëria nuk është akoma vend anëtar i BE-së.
Kap 3–13, 14, 15, 16, 17	15, 16, 17, 18, 19, 20, 21	E pjesshme	Shqipëria nuk është akoma vend anëtar i BE-së dhe, po ashtu, ka detyrime për struktura të tjera evropiane.
Kap. 4 – 18, 19, 20, 21, 22	22, 23, 24, 25, 26, 27	E pjesshme	Shqipëria nuk është akoma vend anëtar i BE-së dhe, po ashtu, ka detyrime për struktura të tjera evropiane.
Kap 5–23, 24, 25	28	E pjesshme	Shqipëria nuk është akoma vend anëtar i BE-së dhe, po ashtu, ka detyrime për struktura të tjera evropiane.
Kap. 6–26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35.	NA	NA	Lidhen me detyrime të komisionit dhe strukturave të tij, dhe disa prej tyre, si ato të ruajtjes së të dhënave janë të përshkruara në ligjin nr. 15/2016 dhe ligje të tjera.

URDHËR

Nr. 11, datë 7.1.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E POLONISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
1.	Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Susz*
2.	Warmińsko-Mazurskie	Kętrzyn	Reszel*
3.	Wielkopolskie	Ostrzeszów	Mikstaj*
4.	Wielkopolskie	Turek	Kawęczyn*
5.	Wielkopolskie	Turek	Przykona*
6.	Warmińsko-Mazurskie	Ostróda	Grunwald*
7.	Wielkopolskie	Konin	Rzgów*
8.	Warmińsko-Mazurskie	Węgorzewo	Pozezdrze*
9.	Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Ilawa (rural)*
10.	Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Zalewo*
11.	Małopolskie	Tarnów	Wojnicz*
12.	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Środa Wielkopolska*
13.	Lubuskie	Międzyrzecz	Skwierzyna*
14.	Warmińsko-Mazurskie	Bartoszyce	Bartoszyce (rural)*
15.	Lubuskie	Sulcin	Krzyszczewo*
16.	Mazowieckie	Białobrzegi	Stara Błotnica*
17.	Kujawsko-Pomorskie	Inowrocław	Gniewkowo*
18.	Opolskie	Namysłów	Pokój*
19.	Kujawsko-Pomorskie	Chełmno	Lisewo*
20.	Lubuskie	Świebodzin	Lubrza*
21.	Lubuskie	Gorzów	Deszczno*
22.	Wielkopolskie	Poznań	Mosina*
23.	Warmińsko-Mazurskie	Nidzica	Janowiec Kościelny*
24.	Warmińsko-Mazurskie	Węgorzewo	Węgorzewo*
25.	Mazowieckie	Zuromin	Lutocin*
26.	Pomorskie	Kartuzy	Somonino*
27.	Łódzkie	Podgibice	Pęczniew*
28.	Pomorskie	Słupsk	Kobylnica*



29.	Wielkopolskie	Kalisz	Szczytniki*
30.	Wielkopolskie	Kalisz	Koźminek*
31.	Lubuskie	Żagań	Malomice*
32.	Lubuskie	Gorzów	Bogdaniec*
33.	Lubelskie	Parczew	Siemien*
34.	Lubelskie	Radzyń Podlaski	Wohyń*
35.	Lubelskie	Biała Podlaska	Międzyrzec Podlaski (rural)*

Sbënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informon të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

7. Urdhri nr. 3, datë 5.1.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR

Nr. 12, datë 7.1.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E FRANCËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Francës, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
1.	Hauts-de-France	Pas-de-Calais	Calais*
2.	Pays de la Loire	Maine-et-Loire	Chollet*
3.	Pays de la Loire	Loire-Atlantique	Châteaubriant*
4.	Pays de la Loire	Vendée	Fontenay-le-Comte*
5.	Nouvelle-Aquitaine	Lot-et-Garonne	Nérac*
6.	Grand Est	Haute-Marne	Saint-Dizier*
7.	Centre-Val de Loire	Cher	Bourges*
8.	Auvergne-Rhône-Alpes	Allier	Moulins*
9.	Auvergne-Rhône-Alpes	Loire	Montbrison*
10.	Bourgogne-Franche-Comté	Côte-d'Or	Beaune*
11.	Bourgogne-Franche-Comté	Côte-d'Or	Dijon*
12.	Grand Est	Marne	Vitry-le-François*
13.	Pays de la Loire	Loire-Atlantique	Nantes*
14.	Pays de la Loire	Vendée	Les Sables-d'Olonne*
15.	Pays de la Loire	Vendée	La Roche-sur-Yon*
16.	Nouvelle-Aquitaine	Deux-Sèvres	Bressuire*
17.	Nouvelle-Aquitaine	Deux-Sèvres	Parthenay*
18.	Nouvelle-Aquitaine	Dordogne	Périgueux*
19.	Auvergne-Rhône-Alpes	Ain	Bourg-en-Bresse*
20.	Pays de la Loire	Loire-Atlantique	Saint-Nazaire*
21.	Nouvelle-Aquitaine	Haute-Vienne	Bellac*



22.	Île-de-France	Yvelines	Rambouillet*
23.	Nouvelle-Aquitaine	Dordogne	Bergerac*
24.	Hauts-de-France	Somme	Abbeville*
25.	Centre-Val de Loire	Loir-et-Cher	Romorantin-Lanthenay*
26.	Nouvelle-Aquitaine	Landes	Dax*
27.	Bretagne	Finistère	Morlaix*
28.	Normandie	Calvados	Bayeux*
29.	Bretagne	Côtes-d'Armor	Saint-Brieuc*
30.	Hauts-de-France	Nord	Dunkerque*
31.	Drôme*	-	-
32.	Vendée*	-	-

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuar para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

7. Urdhri nr. 4, datë 5.1.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Francës”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR

Nr. 13, datë 7.1.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E BULLGARISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Bullgarisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	*Ndarja administrative e nivelit 2
1.	Haskovo	Haskovo*
2.	Plovdiv	Rakovski*
3.	Burgas	Aitos*
4.	Plovdiv	Maritsa*
5.	Plovdiv	Brezovo*
6.	Plovdiv	Sadovo*
7.	Pazardzhik	Pazardzhik*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informon të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të



patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara sipas pikës 2 të këtij urdhri.

7. Urdhri nr. 1034, datë 17.10.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Bullgarisë”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 14, datë 7.1.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E GJERMANISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
1.	Brandenburg	Märkisch-Oderland	Neuhardenberg*
2.	Bayern	Dingolfing-Landau	Simbach*
3.	Schleswig-Holstein	Steinburg	Krempelmarsch*
4.	Schleswig-Holstein	Steinburg	Schenefeld*
5.	Mecklenburg-Vorpommern	Rostock	Tessin*
6.	Mecklenburg-Vorpommern	Ludwigslust-Parchim	Ludwigslust-Land*
7.	Nordrhein-Westfalen	Paderborn	Delbrück*
8.	Nordrhein-Westfalen	Recklinghausen	Dorsten*
9.	Thüringen	Greiz	Zeulenroda-Triebes*
10.	Schleswig-Holstein	Plön	Lütjenburg*
11.	Niedersachsen	Cloppenburg	Garnel*
12.	Niedersachsen	Diepholz	Stuhr*
13.	Brandenburg	Potsdam-Mittelmark	Beetzsee*
14.	Mecklenburg-Vorpommern	Mecklenburgische Seenplatte	Rebel-Münitz*
15.	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Greifswald	Torgelow-Ferdinandshof*
16.	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Rügen	Bergen auf Rügen*
17.	Brandenburg	Oberhavel	Kreimmen*
18.	Baden-Württemberg	Alb-Donau-Kreis	Langenau*
19.	Niedersachsen	Cloppenburg	Bösel*
20.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Geldern*
21.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Goch*
22.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Rees*
23.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Kevelaer*
24.	Niedersachsen	Vechta	Vechta*
25.	Brandenburg	Märkisch-Oderland	Barnim-Oderbruch*
26.	Brandenburg	Prignitz	Plattinburg*
27.	Niedersachsen	Diepholz	Barnstorf*
28.	Schleswig-Holstein	Nordfriesland	Föhr-Amrum*
29.	Schleswig-Holstein	Nordfriesland	Sylt*
30.	Niedersachsen	Emsland	Geeste*
31.	Niedersachsen	Stade	Fredenbeck*
32.	Niedersachsen	Harburg	Tostedt*
33.	Niedersachsen	Oldenburg	Ganderkesee*
34.	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Greifswald	Penetal/Loitz*
35.	Brandenburg	Märkisch-Oderland	Letschin*
36.	Brandenburg	Märkisch-Oderland	Wriezen*
37.	Hessen	Wetteraukreis	Rockenberg*
38.	Niedersachsen	Cloppenburg	Friesoythe*
39.	Brandenburg	Uckermark	Lychen*
40.	Nordrhein-Westfalen	Wesel	Kamp-Lintfort*
41.	Niedersachsen	Rotenburg (Wümme)	Selsingen*
42.	Niedersachsen	Vechta	Goldenstedt*
43.	Thüringen	Nordhausen	Ellrich*
44.	Sachsen-Anhalt	Mansfeld-Südharz	Goldene Aue*
45.	Niedersachsen	Emsland	Lenggerich*
46.	Niedersachsen	Rotenburg (Wümme)	Bremervörde*
47.	Niedersachsen	Stade	Oldendorf-Himmelpforten*
48.	Niedersachsen	Oldenburg	Harstedt*
49.	Niedersachsen	Diepholz	Altes Amt Lemförde*
50.	Niedersachsen	Diepholz	Rehden*
51.	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Rügen	Miltzow*
52.	Sachsen	Meißen	Ebersbach*
53.	Bayern	Straubing-Bogen	Geiselhöring*
54.	Nordrhein-Westfalen	Rhein-Erft-Kreis	Hürth*
55.	Niedersachsen	Verden	Thedinghausen*
56.	Niedersachsen	Oldenburg	Großenkneten*
57.	Nordrhein-Westfalen	Gütersloh	Rietberg*
58.	Nordrhein-Westfalen	Gütersloh	Verl*



59.	Schleswig-Holstein	Segeberg	Trave-Land*
60.	Niedersachsen	Grafschaft Bentheim	Wietmarschen*
61.	Nordrhein-Westfalen	Coesfeld	Lüdinghausen*
62.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Kleve*
63.	Schleswig-Holstein	Segeberg	Leezen*
64.	Niedersachsen	Oldenburg	Dötlingen*
65.	Sachsen-Anhalt	Anhalt-Bitterfeld	Zerbst/Anhalt*
66.	Nordrhein-Westfalen	Gütersloh	Versmold*
67.	Schleswig-Holstein	Ostholstein	Fehmarn*
68.	Niedersachsen	Aurich	Dornum*
69.	Nordrhein-Westfalen	Viersen	Kempfen*
70.	Niedersachsen	Gloppenburg	Saterland*
71.	Niedersachsen	Osnabrück	Ostercappeln*
72.	Sachsen	Leipzig	Grimma*
73.	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Rügen	Recknitz-Trebelhal*
74.	Sachsen-Anhalt	Altmarkkreis Salzwedel	Gardlegen*
75.	Niedersachsen	Embsland	Haselünne*
76.	Brandenburg	Havelland	Ketzin/Havel*
77.	Baden-Württemberg	Schwarzwald-Baar-Kreis	Donaueschingen*
78.	Sachsen	Nordsachsen	Wernsdorf*
79.	Nordrhein-Westfalen	Hamm	Hamm*
80.	Niedersachsen	Rotenburg (Wümme)	Sottrum*
81.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Weeze*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

7. Urdhri nr. 5, datë 5.1.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 15, datë 7.1.2026

**PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT
NR. 1259, DATË 26.11.2025, “PËR
DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E MBRETËRISË
SË BASHKUAR”**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës; pikës 3, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 1259, datë 26.11.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Mbretërisë së Bashkuar”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla



URDHËR I PËRBASHKËT
Nr. 602, datë 17.12.2025

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË RREGULLOREN PËR ZHVILLIMIN E
MATURËS SHTETËRORE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 69, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 15/2017, datë 16.2.2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJMË:

I. Në rregulloren “Për zhvillimin e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë”, të miratuar me urdhrin e përbashkët nr. 661, datë 1.12.2023, të ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit përgjegjës për arsimin profesional, “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Kudo në rregullore fjalët “Ministria e Arsimit dhe Sportit” dhe akronimi “MAS” të zëvendësohen me fjalët “Ministria e Arsimit” dhe “MA”.

2. Pas pikës 1, të nenit 4, shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit.”.

3. Në pikën 17, të nenit 6, data “10 korrik” zëvendësohet me datën “9 korrik”.

4. Pika 4, e nenit 7, ndryshon si vijon:

“4. Dërgon zyrtarisht në QSHA, në DRAP dhe në institucionet e arsimit profesional, si dhe hedh në sistemin *e-Matura*, dy ditë pas përfundimit të shkollës, listën e maturantëve që nuk mund të japin provimet e maturës, si rezultat i mospërfundimit me sukses të vitit të fundit të shkollës së mesme.”.

5. Në fund të shkronjës “j”, të pikës 2, të nenit 8, shtohet fjalia:

“Kryetari i KSHMSH-së verifikon listën e nxënësve mbetës në momentin e hyrjes së nxënësve në qendrën e provimit”.

6. Në fund të fjalisë së dytë, të pikës 2, të nenit 9, shtohet togfjalëshi, si vijon:

“...dhe e përcjell në QSHA.”.

7. Në pikën 2, të nenit 10, togfjalëshi “të ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe ministrit të Financave dhe

Ekonomisë” zëvendësohet me “të ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit përgjegjës për arsimin profesional.”.

8. Pika 5, e nenit 11, ndryshon si vijon:

“5. Diploma e Maturës Shtetërore dhe e Maturës Shtetërore Profesionale lëshohet vetëm një herë. Nga viti 2024 e në vijim, diploma e Maturës Shtetërore gjenerohet përmes sistemit “*e-Matura*” dhe i dërgohet automatikisht çdo maturanti që përfundon me sukses provimet, në llogarinë personale “*e-Albania*”, si dhe në adresën e *email*-it të dhënë në formularin A1/A1Z për shtetasit e huaj.”.

9. Pika 2, e nenit 12, ndryshon si vijon:

“2. Testet e Teorisë Profesionale të integruar, për Maturën Shtetërore Profesionale të dorëzohen nga AKAFPK-ja të hartuara, formatuara dhe në format PDF-je në QSHA. Përgatiten 4 (katër) teste alternative për drejtimet/profilet dhe përzgjidhet vetëm një test për provim.”.

10. Pas pikës 5, të nenit 12, shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. QSHA-ja printon dhe paketon testet e shkollave me seksion dygjuhësh “shqiptaro-italian” për lëndët “gjuhë dhe letërsi italiane, matematikë italiane, fizikë italiane dhe histori italiane”. Testet e këtij seksioni vijnë në zarf dhe elektronikisht nga Ambasada Italiane. Testet e seksionit dygjuhësh “shqiptaro-gjerman” për lëndën “matematikë-gjermane”, vijnë të shumëfishuara dhe paketuara në QSHA. QSHA-ja bën vetëm shpërndarjen e tyre.”.

11. Pika 4 e nenit 13, ndryshon si vijon:

“4. Çdo maturant/kandidat do të plotësojë/firmosë në KSHMSH formularin A1/A1Z për saktësinë e të dhënave të tij në sistemin “*e-Matura*” dhe ky formular ruhet nga KSHMSH-ja deri në përfundimin e vitit shkollor përkatës.”.

12. Pas shkronjës “q”, të pikës 2, të nenit 21, shtohet shkronja “r” me përmbajtjen si vijon:

“r) Përgjegjësi i administrimit të provimit mban përgjegjësi për mospërmbushje të detyrave të përcaktuara në këtë nen, sipas nenit 34 të kësaj rregulloreje.”.

13. Pas shkronjës “r”, të pikës 2, të nenit 22, shtohet shkronja “rr” me përmbajtjen si vijon:

“rr) Administratori i provimit mban përgjegjësi për mospërmbushje të detyrave të përcaktuara në këtë nen, sipas nenit 34 të kësaj rregulloreje.”.

14. Pas shkronjës “g”, të pikës 3, të nenit 23, shtohet shkronja “gj” me përmbajtjen si vijon:



“gj) Administratori i sekretimit mban përgjegjësi për mospërbushje të detyrave të përcaktuara në këtë nen, sipas nenit 34 të kësaj rregulloreje.”

15. Pas shkronjës “h”, të pikës 2, të nenit 24, shtohet shkronja “i” më përmbajtjen si vijon:

“i) Përgjegjësi i katit mban përgjegjësi për mospërbushje të detyrave të përcaktuara në këtë nen, sipas nenit 34 të kësaj rregulloreje.”

16. Në pikat 2, 5, 6, 6/1 dhe 9, të nenit 27, datat “5 korrik” dhe “10 korrik” zëvendësohen përkatësisht me datat “3 korrik” dhe “9 korrik”.

II. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri sekretarët e përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Arsimin Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrtat vendore të arsimit parauniversitar, Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT
Mirela Kumbaro Furxhi

MINISTËR I EKONOMISË DHE
INOVACIONIT
Delina Ibrahimaj

VENDIM
Nr. 381, datë 23.12.2025

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 380, DATË 30.11.2023,
“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
‘PËR VLERËSIMIN ETIK DHE
PROFESIONAL TË DREJTUESVE TË
PROKURORIVE TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM”, TË KËSHILLIT**

Bazuar në nenet 149, pika 1 dhe 149/“a”, pika 1, germa “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në nenet 68 dhe vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; në nenet

159, pika 2, germat “a” dhe “e”, 164, 166, 189, pika 1, germa “c” dhe 190, pika 4, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe në relacionin nr. 3353, datë 23.12.2025, të Grupit të Punës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë

VENDOSI:

I. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në vendimin nr. 380, datë 30.11.2023, “Për miratimin e rregullores ‘Për vlerësimin etik dhe profesional të drejtuesve të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm”, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si vijon:

Neni 1

Në nenin 9, germa “i”, pas shprehjes: “vlerësimi i Prokurorit të Përgjithshëm për funksionimin e policisë gjyqësore në atë prokurori për periudhën e vlerësimit dhe për organizimin dhe funksionimin administrativ të prokurorisë”, shtohet shprehja:

“– mendimi i drejtuesit të Prokurorisë së Apelit për drejtuesit e prokurorive të shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm, lidhur me aspektet e bashkëpunimit dhe komunikimit institucional;”

Neni 2

Në nenin 21, pas paragrafit 2, shtohet një paragraf 2/1, me përmbajtje si më poshtë:

“2/1. Drejtuesi i prokurorisë, përveç sa parashikohet në nenin 9 të kësaj rregulloreje, ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin që shërben për vlerësimin e aftësive të tij profesionale, të sistemuar në dosje ose fashikuj, në përputhje me nenin 96, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në përputhje me metodologjinë e vlerësimit të përcaktuar në aneksin nr. 1, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

Dokumentacioni duhet të jetë i plotë dhe i organizuar sipas treguesve të secilit kriter vlerësimi, nënkritereve dhe elementeve përbërëse të tyre.

Relatori ka të drejtë të kthejë dokumentacionin e paraqitur, në rastet kur ai nuk është i plotë, i sistemuar dhe i renditur në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë pikë, si dhe të kërkojë riparaqitjen e tij, në përputhje me këto kërkesa, brenda afateve të arsyeshme kohore.



Nëse dokumentacioni që mbështet kandidatin nuk dorëzohet brenda afatit të parashikuar në nenin 96, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, konsiderohet se kandidati nuk ka më interes për vazhdimin e procedurës dhe e ka braktisur atë.”.

Neni 3

Në nenin 21, pika 3 e kësaj dispozite riformulohet si më poshtë:

“3. Brenda dy javëve nga krijimi i dosjes së vlerësimit, këshilltari përgjegjës për vlerësimin, nën mbikëqyrjen e relatorit, harton raportin analitik sipas formatit standard të përcaktuar në aneksin nr. 6, bashkëlidhur rregullorës. Raporti analitik përmban listën e akteve të mbledhura gjatë procesit të vlerësimit, si dhe analizën e detajuar dhe të strukturuar të të dhënave të përftuara nga aktet e dosjes së vlerësimit, të cilat evidentojnë mosplotësimin e ndonjë treguesi të vlerësimit, nëntreguesi ose elementi përbërës të tyre.”.

Neni 4

Në nenin 22, pika 3, pas fjalëve “(...) nga aktet e përcaktuara në këtë rregullore”, shtohet shprehja: “, të cilat evidentojnë mosplotësimin e ndonjë treguesi të vlerësimit, nëntreguesi ose elementi përbërës të tyre.”.

Neni 5

Në “Metodologjinë e vlerësimit”, aneksi nr. 1, pika 10, riformulohet si më poshtë:

“10. Shkalla/cilësia e veprimtarisë drejtuese përcaktohet për secilin nënkriter (indikator) dhe për çdonjërin nga dy kriteret e vlerësimit. Për kriterin e aftësive drejtuese dhe organizative shkalla e pikëzimit është nga 1 deri në 150 pikë, ndërsa për kriterin e aftësive komunikuese shkalla e pikëzimit është nga 1 deri në 50 pikë.”.

Neni 6

Në “Metodologjinë e vlerësimit”, aneksi nr. 1, në pikën 11, pas fjalisë së parë shtohet fjalia, me përmbajtje si më poshtë:

“Mosrespektimi i afateve ligjore të përcaktuara në nenin 96, pika 2, të ligjit nr. 96/2016, “Për

statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ose mosplotësimi i mangësive në përputhje me parashikimet e nenit 21, pika 2/1, të kësaj rregulloreje pas kthimit të dokumentacionit nga relatori, ose mosdorëzimi i dokumentacionit të kërkuar brenda afatit të përcaktuar nga relatori, konsiderohet mangësi në kuadër të vlerësimit të kriterit të aftësive të komunikimit të drejtuesit të prokurorisë dhe penalizohet me ulje prej pesë (5) pikësh nga totali i pikëve të këtij kriteri.”.

Neni 7

Në “Metodologjinë e vlerësimit”, aneksi nr. 1, pas pikës 11, shtohet pika 11/1, me përmbajtje si më poshtë:

“Vlerësimi me pikë i nëntreguesve të përcaktuar në këtë metodologji kryhet sipas skemës së mëposhtme:

1. Për nëntreguesit me vlerësim 1 pikë:

a) Pavarësisht nga numri i elementeve, mosplotësimi i një elementi të nëntreguesit sjell mosdhënien e pikës.

2. Për nëntreguesit me vlerësim 2 pikë:

a) mosplotësimi i një elementi të nëntreguesit sjell mosdhënien e 1 pike;

b) nëse nëntreguesi ka deri në tre elemente, mosplotësimi i dy elementeve ose të tri elementeve sjell mosdhënien e të dy pikëve;

c) nëse nëntreguesi ka më shumë se tre elemente, atëherë: mosplotësimi i gjysmës së numrit të elementeve sjell mosdhënien e 1 pike; mosplotësimi i më shumë se gjysmës apo i të gjitha elementeve sjell mosdhënien e 2 pikëve.

3. Për nëntreguesit me vlerësim 3 pikë:

a) mosplotësimi i një elementi të nëntreguesit sjell mosdhënien e 1 pike;

b) mosplotësimi i dy elementeve, kur nëntreguesi ka vetëm dy të tillë, sjell mosdhënien e 3 pikëve;

c) kur nëntreguesi ka deri në tre elemente, mosplotësimi i dy elementeve, sjell mosdhënien e 2 pikëve. Mosplotësimi i të tre elementeve sjell mosdhënien e 3 pikëve;

d) nëse nëntreguesi ka më shumë se tre elemente, atëherë: mosplotësimi i gjysmës së numrit të elementeve sjell mosdhënien e 1 pike; mosplotësimi i më shumë se gjysmës së numrit të elementeve sjell mosdhënien e 2 pikëve; mosplotësimi i të gjitha elementeve sjell mosdhënien e 3 pikëve.



4. Për nëntreguesit me vlerësim 4 pikë:

- a) mosplotësimi i një elementi të nëntreguesit sjell mosdhënien e 1 pike;
- b) mosplotësimi i dy elementeve sjell mosdhënien e 2 pikëve;
- c) mosplotësimi i tre elementeve sjell mosdhënien e 3 pikëve;
- d) mosplotësimi i të gjitha elementeve të nëntreguesit sjell mosdhënien e 4 pikëve.”.

Neni 8

Në “Metodologjinë e vlerësimit”, aneksi nr. 1, pas pikës 12, “Aftësitë drejtuese dhe organizative” dhe “Aftësitë komunikuese”, ndryshohen si më poshtë:

“1. AFTËSITË DREJTUESE DHE ORGANIZATIVE (150 pikë)

A) Mirëorganizimin e prokurorisë në seksione (30 pikë);

B) Planifikimin e prokurorëve për çështje të natyrës urgjente (20 pikë);

C) Zëvendësimin në kohë të prokurorëve që kanë pengesa në proces (15 pikë);

Ç) Zhvillimin e mbledhjeve tematike për prokurorët (15 pikë);

D) Planifikimin dhe përdorimin efikas të fondeve publike, sipas nevojave të prokurorisë (15 pikë);

E) Mbikëqyrjen për efekt të përmirësimit të informacionit në faqen zyrtare të prokurorisë (15 pikë);

F) Mbikëqyrjen për krijimin e ambienteve të përshtatshme në prokurori, në përputhje me nevojat e palëve e të publikut (15 pikë);

G) Kujdeset për çështjet e ruajtjes dhe të sigurisë në prokurori (15 pikë);

H) Organizimin e trajnimeve për prokurorët dhe punonjësit e prokurorisë (10 pikë).

2. AFTËSITË KOMUNIKUESE (50 pikë)

A) Bashkëpunimin efektiv dhe në kohë me Këshillin, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, Ministrinë e Drejtësisë, Kontrollin e Lartë të Shtetit ose me çdo institucion tjetër mbikëqyrjeje, ose auditit (30 pikë);

B) Komunikimin me publikun dhe të tretët, duke caktuar saktësisht oraret për pritjen e publikut, dokumentacionin e takimeve ose të shkresave për t’iu përgjigjur institucioneve të ndryshme (20 pikë).

3. Pikëzimet e përcaktuara në hyrje të kritereve I (Aftësitë drejtuese dhe organizative) dhe II (Aftësitë

komunikuese) bëhen përkatësisht (150 pikë) dhe (50 pikë).”.

Neni 9

Në “Metodologjinë e vlerësimit”, aneksi nr. 1, në treguesin A “Mirëorganizimin e prokurorisë në seksione” bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Vlerësimi i treguesit “Mirëorganizimin e prokurorisë në seksione” ndryshohet në 30 pikë.

2. Nëntreguesve të shënuar në metodologji me nr. 1, 2, 3, 5, 6, 7, 9, 10, 11 dhe 12, të treguesit “Mirëorganizimin e prokurorisë në seksione” u ndryshohet pikëzimi, duke u pikëzuar me nga 2 (dy) pikë.

3. Tabela e vlerësimit të treguesit “Mirëorganizimin e prokurorisë në seksione” ndryshohet, si vijon:

Shkalla e aftësisë së drejtuesit	Nr. i pikëve
Nën mesatare	7–14
Mesatare	15–22
Mbi mesatare	23–30

Neni 10

Në “Metodologjinë e vlerësimit”, aneksi nr. 1, në treguesin B “Planifikimin e prokurorëve për çështje të natyrës urgjente” bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Vlerësimi i treguesit “Planifikimin e prokurorëve për çështje të natyrës urgjente” ndryshohet në 20 pikë.

2. Nëntreguesve të shënuar në metodologji të treguesit “Planifikimin e prokurorëve për çështje të natyrës urgjente” u ndryshohet pikëzimi duke u pikëzuar me nga 4 (katër) pikë.

3. Tabela e vlerësimit të treguesit “Planifikimin e prokurorëve për çështje të natyrës urgjente” ndryshohet si vijon:

Shkalla e aftësisë së drejtuesit	Nr. i pikëve
Nën mesatare	4–9
Mesatare	10–15
Mbi mesatare	16–20

Neni 11

Në “Metodologjinë e vlerësimit”, aneksi nr. 1, në treguesin C “Zëvendësimin në kohë të prokurorëve që kanë pengesa në proces” bëhen ndryshimet e mëposhtme:



1. Vlerësimi i treguesit “Zëvendësimin në kohë të prokurorëve që kanë pengesa në proces” ndryshohet në 15 pikë.

2. Nëntreguesve të shënuar në metodologji të treguesit “Zëvendësimin në kohë të prokurorëve që kanë pengesa në proces” u ndryshohet pikëzimi duke u pikëzuar me nga 3 (tre) pikë.

3. Tabela e vlerësimit të treguesit “Zëvendësimin në kohë të prokurorëve që kanë pengesa në proces” ndryshohet, si vijon:

Shkalla e aftësisë së drejtuesit	Nr. i pikëve
Nën mesatare	3–7
Mesatare	8–11
Mbi mesatare	12–15

Neni 12

Në “Metodologjinë e vlerësimit”, aneksi nr. 1, në treguesin D “Zhvillimin e mbledhjeve tematike për prokurorët” bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Germëzimi i treguesit “Zhvillimin e mbledhjeve tematike për prokurorët” ndryshohet në germën “C”.

2. Vlerësimi i treguesit “Zhvillimin e mbledhjeve tematike për prokurorët” ndryshohet në 15 pikë.

3. Nëntreguesve të shënuar në metodologji të treguesit “Zhvillimin e mbledhjeve tematike për prokurorët” u ndryshohet pikëzimi duke u pikëzuar me nga 3 (tre) pikë.

4. Tabela e vlerësimit të treguesit “Zhvillimin e mbledhjeve tematike për prokurorët” ndryshohet, si vijon:

Shkalla e aftësisë së drejtuesit	Nr. i pikëve
Nën mesatare	3–7
Mesatare	8–11
Mbi mesatare	12–15

Neni 13

Në “Metodologjinë e vlerësimit”, aneksi nr. 1, në treguesin E “Planifikimin dhe përdorimin efikas të fondeve publike, sipas nevojave të prokurorisë” bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Germëzimi i treguesit “Planifikimin dhe përdorimin efikas të fondeve publike, sipas nevojave të prokurorisë” ndryshohet në germën “D”.

2. Vlerësimi i treguesit “Planifikimin dhe përdorimin efikas të fondeve publike, sipas nevojave të prokurorisë” ndryshohet në 15 pikë.

3. Nëntreguesve të shënuar në metodologji të treguesit “Planifikimin dhe përdorimin efikas të fondeve publike, sipas nevojave të prokurorisë” u ndryshohet pikëzimi duke u pikëzuar me nga 3 (tre) pikë.

4. Tabela e vlerësimit të treguesit “Planifikimin dhe përdorimin efikas të fondeve publike, sipas nevojave të prokurorisë” ndryshohet, si vijon:

Shkalla e aftësisë së drejtuesit	Nr. i pikëve
Nën mesatare	3–7
Mesatare	8–11
Mbi mesatare	12–15

Neni 14

Në “Metodologjinë e vlerësimit”, aneksi nr. 1, në treguesin F “Mbikëqyrjen për efekt të përmirësimit të informacionit në faqen zyrtare të prokurorisë” bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Germëzimi i treguesit “Mbikëqyrjen për efekt të përmirësimit të informacionit në faqen zyrtare të prokurorisë” ndryshohet në germën “E”.

2. Vlerësimi i treguesit “Mbikëqyrjen për efekt të përmirësimit të informacionit në faqen zyrtare të prokurorisë” ndryshohet në 15 pikë.

3. Nëntreguesve të shënuar në metodologji të treguesit “Mbikëqyrjen për efekt të përmirësimit të informacionit në faqen zyrtare të prokurorisë” u ndryshohet pikëzimi duke u pikëzuar me nga 3 (tre) pikë.

4. Tabela e vlerësimit të treguesit “Mbikëqyrjen për efekt të përmirësimit të informacionit në faqen zyrtare të prokurorisë” ndryshohet, si vijon:

Shkalla e aftësisë së drejtuesit	Nr. i pikëve
Nën mesatare	3–7
Mesatare	8–11
Mbi mesatare	12–15

Neni 15

Në “Metodologjinë e vlerësimit”, aneksi nr. 1, në treguesin G “Mbikëqyrjen, për krijimin e ambienteve të përshtatshme në prokurori, në përputhje me nevojat e palëve dhe publikut” bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Germëzimi i treguesit “Mbikëqyrjen, për krijimin e ambienteve të përshtatshme në prokurori, në përputhje me nevojat e palëve dhe publikut” ndryshohet në germën “F”.



2. Vlerësimi i treguesit “Mbikëqyrjen, për krijimin e ambienteve të përshtatshme në prokurori, në përputhje me nevojat e palëve dhe publikut” ndryshohet në 15 pikë.

3. Nëntreguesi nr. 8, “Marrija e masave për vënien në funksionim dhe zbatimin e së drejtës së magjistratit për aplikimin e skemës së huamarrjes së kredisë për shtëpi”, i treguesit “Mbikëqyrjen, për krijimin e ambienteve të përshtatshme në prokurori, në përputhje me nevojat e palëve dhe publikut”, shfuqizohet.

4. Nëntreguesit nr. 9 dhe nr. 10, të treguesit “Mbikëqyrjen, për krijimin e ambienteve të përshtatshme në prokurori, në përputhje me nevojat e palëve dhe publikut” numërohen përkatësisht nr. 8 dhe nr. 9.

5. Nëntreguesve të shënuar në metodologji me nr. 1, 2, 3, 6, 8 dhe 9, të treguesit “Mbikëqyrjen, për krijimin e ambienteve të përshtatshme në prokurori, në përputhje me nevojat e palëve dhe publikut” u ndryshohet pikëzimi duke u pikëzuar me nga 2 (dy) pikë.

6. Tabela e vlerësimit të treguesit “Mbikëqyrjen, për krijimin e ambienteve të përshtatshme në prokurori, në përputhje me nevojat e palëve dhe publikut” ndryshohet, si vijon:

Shkalla e aftësisë së drejtuesit	Nr. i pikëve
Nën mesatare	3–7
Mesatare	8–11
Mbi mesatare	12–15

Neni 16

Në “Metodologjinë e vlerësimit”, aneksi nr. 1, në treguesin H “Kujdeset për çështjet e ruajtjes dhe sigurisë në prokurori” bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Germëzimi i treguesit “Kujdeset për çështjet e ruajtjes dhe sigurisë në prokurori” ndryshohet në germën “G”.

2. Vlerësimi i treguesit “Kujdeset për çështjet e ruajtjes dhe sigurisë në prokurori” ndryshohet në 15 pikë.

3. Nëntreguesve të shënuar në metodologji me nr. 1, 2, 4, 7 dhe 9, të treguesit “Kujdeset për çështjet e ruajtjes dhe sigurisë në prokurori” u ndryshohet pikëzimi duke u pikëzuar me nga 2 (dy) pikë.

4. Tabela e vlerësimit të treguesit “Kujdeset për çështjet e ruajtjes dhe sigurisë në prokurori” ndryshohet, si vijon:

Shkalla e aftësisë së drejtuesit	Nr. i pikëve
Nën mesatare	3–7
Mesatare	8–11
Mbi mesatare	12–15

Neni 17

Në “Metodologjinë e vlerësimit”, aneksi nr. 1, në treguesin I “Organizimin e trajnimeve për prokurorët dhe punonjësit e prokurorisë” bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Germëzimi i treguesit “Organizimin e trajnimeve për prokurorët dhe punonjësit e prokurorisë” ndryshohet në germën “H”.

Neni 18

Në “Metodologjinë e vlerësimit”, aneksi nr. 1, pas shprehjes “pikëzimi dhe përcaktimi i cilësisë së veprimtarisë drejtuese për kriterin I” bëhet ndryshimi i tabelës së vlerësimit, si më poshtë:

Shkalla e aftësisë së drejtuesit, kriteri I	Nr. i pikëve
Nën mesatare	38–74
Mesatare	75–112
Mbi mesatare	113–150

Neni 19

Në “Metodologjinë e vlerësimit”, aneksi nr. 1, në treguesin A “Bashkëpunimi efektiv dhe në kohë me Këshillin, ILD, MD, KLSH ose me çdo institucion tjetër mbikëqyrjeje ose auditit” bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Vlerësimi i treguesit “Bashkëpunimi efektiv dhe në kohë me Këshillin, ILD, MD, KLSH ose me çdo institucion tjetër mbikëqyrjeje ose auditit” ndryshohet në 30 pikë.

2. Nëntreguesve të shënuar në metodologji me nr. 1, 2, 3, 4, 6, 7, 8, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 19, 20, 21, 22, 24 dhe 25, të treguesit “Bashkëpunimi efektiv dhe në kohë me Këshillin, ILD, MD, KLSH ose me çdo institucion tjetër mbikëqyrjeje ose auditit” u ndryshohet pikëzimi duke u pikëzuar me nga 1 (një) pikë.

3. Tabela e vlerësimit të treguesit “Bashkëpunimi efektiv dhe në kohë me Këshillin, ILD, MD, KLSH ose me çdo institucion tjetër mbikëqyrjeje ose auditit” ndryshohet si vijon:

Shkalla e aftësisë së drejtuesit	Nr. i pikëve
Nën mesatare	8–14
Mesatare	15–22
Mbi mesatare	23–30



Neni 20

Në “Metodologjinë e vlerësimit”, aneksi nr. 1, në treguesin B “Komunikimin me publikun dhe të tretët, duke caktuar saktësisht oraret për pritjen e publikut, dokumentacionin e takimeve ose të shkresave për t’iu përgjigjur institucioneve të ndryshme” bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Vlerësimi i treguesit “Komunikimin me publikun dhe të tretët, duke caktuar saktësisht oraret për pritjen e publikut, dokumentacionin e takimeve ose të shkresave për t’iu përgjigjur institucioneve të ndryshme” ndryshohet në 20 pikë.

2. Nëntreguesve të shënuar në metodologji me nr. 1 dhe 10, të treguesit “Komunikimin me publikun dhe të tretët, duke caktuar saktësisht oraret për pritjen e publikut, dokumentacionin e takimeve ose të shkresave për t’iu përgjigjur institucioneve të ndryshme” u ndryshohet pikëzimi duke u pikëzuar me nga 3 (tre) pikë.

3. Nëntreguesve të shënuar në metodologji me nr. 2, 3, 4, 5, 8 dhe 9, të treguesit “Komunikimin me publikun dhe të tretët, duke caktuar saktësisht oraret për pritjen e publikut, dokumentacionin e takimeve ose të shkresave për t’iu përgjigjur institucioneve të ndryshme” u ndryshohet pikëzimi duke u pikëzuar me nga 2 (dy) pikë.

4. Nëntreguesve të shënuar në metodologji me nr. 6 dhe 7, të treguesit “Komunikimin me publikun dhe të tretët, duke caktuar saktësisht oraret për pritjen e publikut, dokumentacionin e takimeve ose të shkresave për t’iu përgjigjur institucioneve të ndryshme” u ndryshohet pikëzimi duke u pikëzuar me nga 1 (një) pikë.

5. Tabela e vlerësimit të treguesit “Komunikimin me publikun dhe të tretët, duke caktuar saktësisht oraret për pritjen e publikut, dokumentacionin e takimeve ose të shkresave për t’iu përgjigjur institucioneve të ndryshme” ndryshohet, si vijon:

Shkalla e aftësisë së drejtuesit	Nr. i pikëve
Nën mesatare	5–9
Mesatare	10–14
Mbi mesatare	15–20

Neni 21

Në “Metodologjinë e vlerësimit”, aneksi nr. 1, pas shprehjes “pikëzimi dhe përcaktimi i cilësisë së veprimtarisë drejtuese për kriterin II” bëhet ndryshimi i tabelës së vlerësimit, si më poshtë:

Shkalla e aftësisë së drejtuesit, kriteri II	Nr. i pikëve
Nën mesatare	13–24
Mesatare	25–37
Mbi mesatare	38–50

Neni 22

Në kriterin “Aftësitë drejtuese dhe organizative”, në treguesin A: “Mirëorganizimin e prokurorisë në seksione”, në nëntreguesin nr. 6 “Mbikëqyrja e disiplinës punë, respektimit të etikës të prokurorit ...”, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

Elementi i renditur i pesti: “Objektiviteti dhe saktësia në dhënien e mendimit për veprimtarinë e magjistratit dhe vlerësimi i tij për këtë veprimtari ...”, shfuqizohet.

Neni 23

Në kriterin “Aftësitë drejtuese dhe organizative”, në treguesin A “Mirëorganizimin e prokurorisë në seksione”, në nëntreguesin nr. 9 “Nxjerrja e udhëzimeve të përgjithshme të natyrës administrative ose procedurale dhe udhëzimeve për çështje konkrete për prokurorët e prokurorisë përkatëse”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Shprehja “ose procedurale” hiqet.

2. Elementi i renditur i dyti në këtë nëntregues: “Nxjerrja e udhëzimeve procedurale penale, apo lidhur me zbatimin e ligjit penal material, me qëllim unifikimin e praktikave brenda prokurorisë, ndjekja e zhvillimeve të legjislacionit ...”, shfuqizohet.

Neni 24

Në kriterin “Aftësitë drejtuese dhe organizative”, në treguesin A “Mirëorganizimin e prokurorisë në seksione”, nëntreguesi nr. 13 “Mbikëqyrja tematike për grupvepra ose seksione pranë prokurorisë, të cilat nga raportet dhe analizat e kryera, rezultojnë problematike në drejtim të eficiencës për kryerjen e hetimeve penale dhe/ose respektimin e kërkesave ligjore procedurale penale”, riformulohet, si më poshtë:

“Mbikëqyrja tematike e veprimtarisë së policisë gjyqësore, për grupvepra ose seksione pranë prokurorisë, të cilat nga raportet dhe analizat e kryera, rezultojnë problematike në drejtim të eficiencës për kryerjen e hetimeve penale dhe/ose respektimin e kërkesave ligjore procedurale penale.”.



Neni 25

Në kriterin “Aftësitë drejtuese dhe organizative”, në treguesin A “Mirëorganizimin e prokurorisë në seksione”, nëntreguesi nr. 15 “Zhvillimi i mbledhjeve tematike me prokurorët e seksioneve, prokurorët e caktuar për ndjekjen e çështjeve apo me drejtuesit e policisë gjyqësore të seksioneve apo të strukturave hetimore në shërbimet e policisë gjyqësore, të caktuar për ecurinë në kryerjen e hetimeve për veprat penale prioritare të rekomanduara” riformulohet, si më poshtë:

“Zhvillimi i mbledhjeve tematike me drejtuesit e policisë gjyqësore të seksioneve apo të strukturave hetimore në shërbimet e policisë gjyqësore, të caktuar për ecurinë në kryerjen e hetimeve për veprat penale prioritare të rekomanduara”.

Neni 26

Në kriterin “Aftësitë drejtuese dhe organizative”, në treguesin A “Mirëorganizimin e prokurorisë në seksione”, në nëntreguesit e mëposhtëm bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në nëntreguesin 7, “Garantimi i zbatimit korrekt të udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm”, shfuqizohet elementi i renditur i dyti: “Analizimi dhe diskutimi i tyre në mbledhjen e prokurorëve”.

2. Në nëntreguesin 10, “Marraja e masave administrative-procedurale, miratimi i udhëzimeve të përgjithshme dhe planit të veprimit për të siguruar zbatimin e rekomandimeve prioritare”, nga elementi i renditur i parë shfuqizohet pjesa e formulimit:

“...organizimi i mbledhjes për diskutim dhe dhënie mendimi për masat, aktivitetet dhe mënyrën e zbatimit”.

3. Në nëntreguesin 13, “Mbikëqyrja tematike e veprimtarisë së policisë gjyqësore për grupvepra ose seksione pranë prokurorisë, të cilat nga raportet dhe analizat e kryera rezultojnë problematike në drejtim të eficiencës për kryerjen e hetimeve penale dhe/ose respektimin e kërkesave ligjore procedurale penale”, shfuqizohet elementi i renditur i tretë: “Organizimi i mbledhjeve të prokurorëve për të analizuar dhe trajtuar rezultatet e arritura”.

4. Në nëntreguesin 15, “Zhvillimi i mbledhjeve tematike me drejtuesit e policisë gjyqësore të seksioneve apo të strukturave hetimore në shërbimet e policisë gjyqësore, të caktuar për ecurinë

në kryerjen e hetimeve për veprat penale prioritare të rekomanduara”, shfuqizohet elementi i renditur i parë: “Organizimi i mbledhjeve, takimeve periodike me tematikë me prokurorët e seksioneve, prokurorët e caktuar për ndjekjen e çështjeve. Dokumentimi i këtyre mbledhjeve. Rëndësia e çështjeve të ngritura, përfundimet e arritura, masat e marra dhe efikasiteti i tyre”.

5. Në nëntreguesin 16, “Mbikëqyrja periodike e veprimtarisë së prokurorisë, edhe nëpërmjet analizës së treguesve të gjendjes së kriminalitetit (...)”, shfuqizohet elementi i renditur i tretë: “Organizimi i mbledhjes së prokurorëve për të diskutuar mbi rezultatet e analizës dhe mbikëqyrjes, evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre”.

6. Në nëntreguesin 19, “Marraja e masave për nxitjen e hetimit kryesisht nga drejtuesi i prokurorisë, apo prokurorët e tjerë në drejtimet prioritare të rekomanduara”, shfuqizohet elementi i renditur i katërt: “Organizimi i mbledhjeve të prokurorëve për të analizuar problematikat e vërejtura gjatë ecurisë së këtyre procedimeve dhe zgjidhja e tyre”.

Neni 27

Në kriterin “Aftësitë drejtuese dhe organizative”, në treguesin Ç “Zhvillimin e mbledhjeve tematike për prokurorët”, në nëntreguesin nr. 1, përpara dy elementeve ekzistuese të tij, shtohen edhe elementet e mëposhtme:

– Analizimi dhe diskutimi i udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm në mbledhjen e prokurorëve;

– Organizimi i mbledhjes për diskutim dhe dhënie mendimi për masat, aktivitetet dhe mënyrën e zbatimit të rekomandimeve prioritare;

– Organizimi i mbledhjeve të prokurorëve për të analizuar problematikat e vërejtura gjatë ecurisë së hetimeve të procedimeve penale në drejtimet prioritare të rekomanduara dhe zgjidhja e tyre;

– Organizimi i mbledhjeve, takimeve periodike me tematikë me prokurorët e prokurorisë dhe prokurorët e seksioneve për ndjekjen e çështjeve. Dokumentimi i këtyre mbledhjeve. Rëndësia e çështjeve të ngritura, përfundimet e arritura, masat e marra dhe efikasiteti i tyre;

– Organizimi i mbledhjeve të prokurorëve për të analizuar dhe trajtuar rezultatet e arritura në mbikëqyrjen e veprimtarisë së policisë gjyqësore;



- Organizimi i mbledhjes së prokurorëve për të diskutuar mbi rezultatet e analizës së treguesve të gjendjes së kriminalitetit, evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre;”.

Neni 28

Në kriterin “Aftësitë komunikuese”, në treguesin A, “Bashkëpunimi efektiv dhe në kohë me Këshillin, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë ...(...)”, nëntreguesi 6, “Garantimi i zbatimit të vendimeve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm”, ndryshohet si më poshtë:

“Garantimi i zbatimit të vendimeve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”.

Neni 29

Me miratimin e këtij vendimi, në aneksin nr. 1 “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të drejtuesit të prokurorisë së juridiksionit të përgjithshëm”, shënimet fundore (*footnote*) shfuqizohen.

Neni 30

Ndryshimet e përcaktuara në këtë vendim nuk zbatohen për drejtuesit e zyrave të prokurorive që janë ende në proces vlerësimi nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale pranë Këshillit.

II. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 23.12.2025.

KRYETAR
Mirela Bogdani

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 128 lekë

